

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

Korrik, 2017r.

Nr. 7/2017

Rajnhard Pribe dhe ekipi i tij i ekspertëve në vizitë të Agjencisë



Në kuadër të zbatimit të Prioriteteve urgjente reformuese që dolën nga Raporti me rekomandimet e vitit 2015, Drejtori dhe anëtarë të Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatiqe audio dhe audiovizuale, më 20 korrik 2017, realizuan takim pune me ekipin e ekspertëve të udhëhequr nga Rajnhard Pribe.

Në takim u bisedua për mënyrën e funksionimit të trupit rregullator pas hyrjes në fuqi të Ligjit për shërbime mediatiqe audio dhe audiovizuale dhe Ligjit për medime, pavarësisht politike dhe financiare të Agjencisë, transparencës së saj, si dhe dobësitë e sferës mediatiqe dhe nevojës për tejkalimin e tyre, vecanërisht në drejtim të sanksionimit të gjuhës së urrejtjes, respektimit të standardeve profesionale të gazetarisë si dhe sigurimit të kryerjes së punës së gazetareve.

U nënshkrua Memorandum për bashkëpunim me Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë“




Agjencia për shërbime mediatiqe audio dhe audiovizuale dhe Fakulteti Juridik “Justiniani i Parë”, më 7 korrik 2017, nënshkruan Memorandum bashkëpunimi, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit që do të kontribuojë për shkëmbimin e përvojave dhe konfirmimi të përpjekjeve të përbashkëta dhe interesit për avancimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, si dhe punës shkencore-hulumtuese dhe aplikuese.

Të dy institucionet do të bashkëpunojnë për përpilimin e projekteve të përbashkëta hulumtuese dhe do të japin ndihmë të ndërsjellë gjatë organizimit të seminareve, takimeve shkencore, tryezave të rrumbullakta dhe formave tjera të ngjarjeve me interes të përbashkët, përdieria për studentët e fakultetit hapet mundësi për realizimin e mësimit praktik në Agjenci.

Reagimet e Agjencisë lidhur me pengimin e gazetarëve gjatë kryerjes së punës së tyre

Agjencia në korrik dy her reagoi lidhur me pengimin e gazetarëve gjatë kryerjes së obligimit të tyre profesional. Në rastin e parë, pas njoftimit nga ana e televizionit Kanal Vis nga Strumica, se ekipi i tyre i gazetarëve që ka ndjekur një sancë publike të Këshillit të Komunës Novo Sello, jo vetëm që kanë qenë të penguar në detyrën e tyre profesionale, por janë ekspozuar edhe në sulme verbale. Agjencia në aspekt të këtij incidenti, i ka dënuar të gjitha format e presionit dhe ofendimeve ndaj gazetarëve dhe punëtorëve mediatic dhe përsëri ftuan që të respektohen profesioni i gazetarit si dhe dinjteti personal i profesionistëve mediatic.

Në rastin e dytë, Agjencia e dënoi incidentin në komunën e Çairit, ku një ekip i gazetarëve të TV Shenjës ka qenë cak i kërcënimeve nga ana e disa personave që janë deklaruar se janë simpatizues të një partie politike. Agjencia potencoi se esenca e profesionit të gazetarit është që të sigurohet informimi i opinionit për të gjitha çështjet dhe së këndejmë, gazetarët nuk guxojnë që të pengohen gjatë informimit për cilini do problem pa marrë parasysh nëse ai i tangon të gjithë qytetarët ose popullsinë e ndonjë bashkësie lokale. Njëherë, Agjencia përkujton se siguri i kushteve për punë të papenguar të medimeve është parakusht i domosdoshëm për funksionimin e zhvillimit të një shoqërie demokratike.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

Qëndrimet dhe mendimet e Agjencisë lidhur me reformat e propozuara mediatike

Në lidhje me reformat e propozuara në sektorin mediatik, të përfshira në Programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Plani 369, Kërkesa për reformat emergjente të pesë shoqatave/organizatave si dhe propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nga marsi 2016, Agjencia u prononcua me qëndrimet dhe mendimet e veta. Qëndrimet dhe mendimet për reformat e propozuara mediatike, Agjencia i dorëzoi deri te Ministria e Shoqërisë informatike dhe Administratës si dhe deri te të gjitha mediumet, dhe i publikoi në ueb faqen e saj.

Të dhënat për shtrirjen e radiostacioneve si dhe për ndikimin e tyre në shikueshmërin e TV stacioneve, në maj dhe qershor 2017

Agjencia në korrik, në ueb faqen e saj i publikoi të dhënat për shtrirjen e radiostacioneve si dhe për ndikimin e tyre në shikueshmërin e TV stacioneve, në periudhën maj dhe qershor 2017.

Analiza e tregut të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale për vitin 2016

Agjencia e përpiloi Analizën e tregut të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale për vitin 2016. Në këtë analizë janë prezantuar të dhënat për numrin e radiodifuzerëve, performancat e tyre ekonomike në vitin 2016 (të hyrat e përgjithshme, struktura e të hyrave, shpenzimet e përgjithshme si dhe struktura e shpenzimeve, rezultati financiar i punës si dhe numri mesatar i të punësuarve në marrëdhënie të rregullt pune) si dhe të dhënat për shikueshmërinë e televizioneve dhe dëgjueshmërinë e radiostacioneve në vitin 2016.

Mbikëqyrjet / masat e shqiptuara

Mbikëqyrjet e rregullta

Në korrik, Agjencia realizoi mbikëqyrje programore ndaj 13 radiodifuzerëve, lidhur me obligimin – plotësimin e kuotës për vepra evropiane audiovizuale si dhe vepra nga producentë të pavarur. Mbikëqyrja tregoi se të gjithë radiodifuzerët kanë vepruar sipas dispozitave ligjore.

Është realizuar edhe mbikëqyrja administrative ndaj të gjithë 130 radiodifuzerëve që emetojnë TV ose radio program, për obligimin - publikimi i të dhënave deri më 30 qershor 2017, lidhur me strukturën pronësore, redaksinë dhe burimet e financimit në vitin e kaluar, si dhe dorëzimin e incizimeve nga ky publikim deri te Agjencia në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit. Mbikëqyrja edhe në këtë rast tregoi se të gjithë 130 radiodifuzerët e kanë plotësuar obligimin ligjor.

Mbikëqyrjet e jashtëzakonshme

Ndaj radios rajonale RFM Shkup është bërë mbikëqyrje e jashtëzakonshme për përcaktimin e shenjës së identifikimit, me ç'rast është konstatuar se është ndryshe nga ajo që është përcaktuar në lejen për emetim të radios, kurse për ndryshimin nuk është njoftuar Agjencia. Agjencia për këtë shkëlqje ligjore i shqiptoi radiodifuzerit masën e vërejtjes.

Mbikëqyrje e jashtëzakonshme është bërë edhe ndaj operatorit kabllor MULTIMEDIJA-NET, të cilit për shkak të rritjes së ritransmetimit të shërbimeve programore Cartoon Netëork dhe Boomerang, që nuk janë përfshirë me vërtetimet për regjistrim të shërbimeve programore të lëshuara nga Agjencia, i është shqiptuar masa për vërejtje dhe për ç'kycje të ritransmetimit të këtyre shërbimeve programore


AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

rr. Maqedonia nr. 38, 1000 Shkup

Tel. (02) 3103400 faks: (02) 3103401

e-posta: contact@avmu.mk ueb faqia: www.avmu.mk



MKC EN ISO 9001:2009